



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2018, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga ekipi përzgjedhës, lidhur me emërimin e një anëtari të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Rajmonda Islamaj – kandidate për anëtare e bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Anton Shahaj – kandidat për anëtar i bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi- Kolegë deputetë, ju kërkoj ndjesë për vonesën për shkak të një urgjence, pasi më duhej të isha diku.

Në axhendën e ditës së sotme kemi seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga ekipi përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtari të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Të ftuar kemi zonjën Rajmonda Islamaj dhe zotin Enton Shahaj.

Mirë se erdhët në komisioni!

Siç jeni në dijeni ekipi përzgjedhës pas njoftimit për shpalljen e vendeve vakante, që është botuar në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë në shtator të këtij viti dhe bazuar në aplikimet, i ka propozuar parlamentit, komisionit parlamentar dy kandidatura, të cilat i kemi sot të ftuara në komision.

Siç jeni në dijeni, në 25 prill të vitit 2018 njëri prej anëtarëve të bordit rregullator të energjisë i ka përfunduar mandati. Në vijim të njoftimit që është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë kanë paraqitur kandidaturat më datën 12 tetor zoti Enton Shahaj, të cilin do ta dëgjojmë në vijim. Në datën 24 tetor ka paraqitur kandidaturën zonja Rajmonda Islamaj. Të dyja dokumentacionet për të dy kandidatët i keni përpara në tryezë.

Në fillim do të dëgjojmë kandidaturat. Pastaj do t'ia paraqesim seancës parlamentare, e cila do të vendosë se cili do të jetë anëtari i ardhshëm i bordit të Entit Rregullator. Është një bord shumë i rëndësishëm, më vjen keq që një iniciativë ka dështuar, ajo e komponentit financiar. Unë besoj se është një ent, i cili ka nevojë emergjente për t'u rikonceptuar dhe për t'u fuqizuar me kapacitete njerëzore të afta për sfidat që kemi përballë.

Pa humbur kohë do t'ua jap fjalën të ftuarve të ditës së sotme. Pastaj do të vijojmë me pyetje nga ana e kolegëve. Në fund nëse do të ketë diskutime, do të vazhdojmë me to. Jeni dakord me rendin e ditës? Në rregull.

Zoti Shahaj CV-në e kemi përpara, do t'ju luteshim të bënit një përshkrim të shkurtër.

Enton Shahaj – Ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për t'u shprehur në komisionin tuaj!

Siç e kam përshkruar edhe në CV, profesionet e mia janë inxhinier elektrik për energjetikën dhe ekonomist finance. Kam pasur rastin të punoj që herët në sistemin

elektroenergjetik shqiptar që nga viti 1995, pra pak pasi jam diplomuar. Me kalimin e viteve e kam vazhduar përvojën dhe eksperiencën time në sistemin elektroenergjetik me një shkëputje të vogël për arsye të emigrimi, jam rikthyer përsëri dhe kam vazhduar karrierën në vitet 2005-2009 te Qendra e Regjistrimit të Aksioneve. Që nga qershori i vitit 2010 mbaj postin e përgjegjës të Sektorit të Analizës së Kotove dhe Çmimeve në Entin Rregullator të Energjisë. Pas 8 vjetëve të tjera eksperiencë pune në Departamentin e Tarifave dhe të Çmimeve në Entin Rregullator të Energjisë mendova se kishte ardhur momenti duke pasur parasysh përvojën, eksperiencën dhe kualifikimet e mia, një hap tjetër cilësor në karrierë. Kjo ishte arsyeja që më shtyu të aplikoja për postin vakant të anëtarit të bordit të Entit Rregullator të Energjisë.

Për sa u përket imtësive për secilin prej vendeve të punës, ato janë përshkruar më hollësisht në CV-në time.

Jam i nderuar të aplikoj për postin e anëtarit të bordit të Entit Rregullator të Energjisë, se eksperiencia dhe përvoja ime janë të tilla që mund të kontribuoj mjaftueshëm në kryerjen e detyrave që do të mundësonte ai vend dhe më tej hap pas hapi bashkë me kolegët, eprorët apo vartësit në zhvillimi e mëtejshëm të fushave që përfaqësojmë në sektorin energjetik.

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Shahaj!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Kam unë disa pyetje.

Zoti Shahaj CV-ja juaj duket mjaft e pasur edhe në aspektin e përvojave, por edhe në aspektin e trajnimeve. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballet aktualisht Enti Rregullator i Energjisë?

Pyetja e dytë, cilat janë problematikat më të mëdha, meqenëse ju vini nga brenda Entit Rregullator, të këtij institucioni?

Pyetja e tretë, cilat mendoni se janë sfidat më të mëdha të sektorit të energjisë? Ne kemi kaluar nga një sistem pothuajse i kolapsuar disa vite më parë në rimëkëmbje, ndërkohë që deri tani është në rregull, por e ardhmja paraqet sfida të vështira, nga pikëpamja institucionale dhe duke parë burimet e energjisë, a mendoni se do ju ndryshojë diçka në strategjinë e deritanishme për sektorin e energjisë?

Enton Shahaj – Unë e kam lexuar me kujdes Strategjinë Kombëtare për Rimëkëmbjen e Sektorit të Energjisë. Ju sapo e përmendët, është e vërtetë që përballet me sfida dhe me probleme, por kemi parasysh se kur vjen nga një kolaps energjetik i tipit 45% humbje jo më lag se 2013-2014 dhe tani ka arritur nivelin e humbjeve në 26%, është një

punë e konsiderueshme. Nuk po përmend ngërçin e sistemit, që ka një problem të madh aktualisht, i cili ende nuk po zgjidhet, po kjo do të bëhet me bashkëpunim, se nuk është vetëm çështje e Entit Rregullator të Energjisë, do të bëhet me bashkëpunimin e të gjitha palëve, përfshirë qeverinë dhe të gjitha organet e tjera, është mungesa e likuidimit ndërmjet pjesëmarrësve të mëdhenj në tregun e energjisë elektrike, korporatave, që nga prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja. Aty bëhet fjalë për miliarda lekë dhe duhet një vullnet qeveritar, një strategji të mirëfilltë për momentin, për të zgjidhur atë ngërç që askush të mos thotë nesër a pasnesër: “Vërtet e kam përmirësuar ndjeshëm gjendjen nga sa e gjeta, por ende më pengon ngërçi financiar”. Duhet të vijë momenti zero, që themi ne, ky do të vijë, jo vetëm me mbështetjen e ERE-s, por do një vullnet të caktuar politik. Do të vijë momenti zero dhe pastaj do të jenë më të lirë operatorët si të mëdhenjtë edhe të vegjlit, që të mund të tregojnë performancën e tyre reale në sistem.

Për sa u përket problematikave me të cilat përballlet për momentin institucioni, ka pasur zhvillime të vrullshme në tregun e gazit natyror, jo vetëm në tregun e energjisë elektrike si: gazsjellësi TAP-i e të tjera.

Ndoshta duhet të riformatohet institucioni që t’i vijë më për shtat strukturës së tregut, kur kemi parasysh që po fillon të strukturohet, më tej do të zhvillohet një treg edhe për gazin natyror në Shqipëri.

Për sa u përket sfidave në sektorin e energjisë elektrike, nga niveli i humbjeve që u mor në 2013-2014, ka edhe targete, është futja e burimeve të rinovueshme të energjisë, të cilat në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila përditësohet çdo 3 vjet, në vitin 2010 përqindja e burimeve të rinovueshme të energjisë në totalin e portofolit të energjisë ishte në masën 38%. Në vitin 2010 e më pas deri në vitin 2030, se strategjia e fundit flet për vitet 2018-2030 duhet të ketë arritur mbi 35, të paktën një e treta e portofolit të jetë në përmasa të tilla që të përbëhet nga burimet e rinovueshme të energjisë. Këtu kemi parasysh jo vetëm burimet, hidrocentralet e mëdha ekzistuese apo centralet e vegjël, por edhe burimet energjetike nga dielli dhe era.

Performanca e sistemit energjetik ka përmirësime, nga niveli i humbjeve 40 e ca për qind para disa vjetëve, tani ka rritur niveli total i humbjeve në 16 %. Madje në materialet që janë botuar herë pas here nga rregullatori, duke përfshirë edhe raportin vjetor të fundit të ERE-s, bëhet fjalë për vitin 2017, niveli i arkëtimeve të OSHEE-së ishte 97,7%. Ka një problem, nuk është fatura aktuale, kjo ka të bëjë edhe me arkëtimet e prapambetura, por shifra 97,7% e nivelit të arkëtimeve nga OSHEE-ja tregon për përpjekje mjaft serioze në

kryerjen e detyrave. Sistemi është i ristrukturuar në mënyrë të tillë që kur u bë ndarja nuk ishin më vertikalisht të integruar, siç u nda prodhimi nga transmetimi dhe nga shpërndarja, tani po ristrukturohet në mënyrë të tillë që edhe shpërndarja nga shitja të ketë edhe ajo konturet e saj dhe të shkohet drejt hapjes së tregut, drejt krijimit të bursës së energjisë.

Eduard Shalsi - Ka pyetje? Nuk ka.

Faleminderit, për përgjigjet!

Kalojmë te zonja Rajmonda Islamaj.

Mirës erdhe në komision!

Rajmonda Islamaj – Falënderoj të gjitha zonjat, si edhe zotërinjtë e komisionit për këtë dëgjese!

Aplikimi im vjen pas një eksperience tepër të gjatë në sektorin e energjisë elektrike. Kam mbaruar studimet në Fakultetin e Tiranës për ekonomi-financë dhe që nga mbarimi i studimeve kam filluar në ndërmarrjet, që quheshin në atë kohë, sot shoqëritë e sotme, në ndërmarrjen energjetike në Elbasan, më saktë TEC-si i Cërrikut, që ka qenë i bashkuar me sistemin e transmetimit dhe një pjesë me sistemin e shpërndarjes. Për një kohë të shkurtër, trevjeçare kam punuar në këtë TEC, në fillim si ekonomiste normash, më tej llogaritare e parë si financiare. Më tutje kam punuar për një kohë të shkurtër dyvjeçare në Ministrinë e Energjetikës si specialiste për energjetikën në sektorin energjetik. Kam lëvizur me dëshirën time dhe kam shkuar në ndërmarrjen energjetike të Tiranës për të rritur shkallën e specializimit, për të kuptuar më tej fenomenet apo transaksionet që kryen për të qenë më e aftë nga ana financiare.

Në vitin 1992 kam lëvizur me kërkesën e korporatës, kur u krijua Korporata Energjetike Shqiptare, si llogaritare e parë, sot specialiste në Drejtorinë Ekonomike të korporatës. Jam marrë me konsolidimet financiare të sistemit, të gjithë degëve, sot të ashtuquajtura prodhim-transportim dhe shpërndarje.

Më tej kam punuar si drejtore ekzekutive ekonomike. Nga viti 1997 deri në 1999 kam mbajtur njëkohësisht edhe pozicionin e projektmenaxheres të financuar nga projekti i Bankës Botërore në lidhje me modernizimin e financës së KESH-it. Më vonë nga 1 shtatori i vitit 1999 kam punuar në Entin Rregullator të Energjisë, i krijuar në vitin 1996, por i ristrukturuar në vitin 1999 sipas ligjit “Për energjinë” si anëtare e bordit të komisionerëve. Në janar të vitit 2007 kam mbaruar këtë funksion. Në maj të vitit 2007 kam punuar si drejtore në Drejtorinë e Tarifave dhe të Çmimeve, një pozicion që e mbaj edhe sot. Gjatë gjithë kësaj kohe kam marrë pjesë në të gjitha forumet, grupet e punës në Europën Juglindore, edhe me

Sekretariatit e Vjenës të grupi i energjisë. Kam punuar për rritjen profesionale duke bërë specializimi pasuniversitare në lidhje me financat. Kam ndjekur edhe trajnime që janë organizuar në fushën e energjisë dhe të gazit natyror. Kam jo vetëm një eksperiencë të gjatë në fushën e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike, por së fundi edhe në fushën e rregullimit të gazit natyror.

Eduard Shalsi - Faleminderit, zonja Rajmonda!

Vlen pak a shumë i njëjti set pyetjesh: cilat janë sfidat e sektorit të energjisë aktualisht? Cilat janë sfidat e Entit Rregullator të Energjisë?

Rajmonda Islamaj - Pavarësisht përmirësimeve të shumta që kemi pasur nga viti 2013 e këtij, kemi një rritje të performancës dhe sfida e këtij sektori është që të ndjekë zhvillimet ekonomike në vend, rritjen ekonomike, duke u përgjigjur me një furnizim të pandërprerë të energjisë elektrike.

Rritja e performancës së kompanisë, të OSSHE-së së pari, humbjet nga 45% në vitin 2013 që ishte niveli maksimal edhe i kostove tepër të larta të shkaktuara deri në prag falimentimi të sistemit, të sektorit të tre kompanive të mëdha, rritja e aftësisë paguese të kësaj kompanie. Ndërkohë kemi në proces ndarjen e kësaj kompanie, në mënyrë që të mos ketë përplasje midis degëve të ekonomisë, për të bëhet më i qartë, më eficient sektori i shpërndarjes së energjisë elektrike me sektorin e furnizimit. Në bazë të ligjit, na kanë ngarkuar që të rregullohen tarifat e transmetimit të rrjeteve të shpërndarjes dhe aty ku ka detyrim të shërbimit publik, i cili sot është furnizuesi universal. Pjesa tjetër është e pakontrolluar.

Çfarë ndodh para rregullatorit? Rregullatori ka sfida jo vetëm t'i përgjigjet, por t'i monitorojë këto kompani. Kjo kërkon specializime, eksperiencë dhe mund që në bashkëpunim me kompanitë të arrijë performancën maksimale dhe nëpërmjet rregulloreve, marrëveshjeve apo monitorimeve për të parë nëse janë korrekte dhe konform ligjit.

Rregullatori ka një sfida jo vetëm performancën e kompanive, por ai duhet të jetë i përgatitur ashtu siç e ka përcaktuar ligji “Për sektorin e energjisë” për hapjen e tregut, krijimin e bursës, duke filluar nga janari i vitit 2019.

Çfarë do të kërkojë kjo nga rregullatori? Rritjen e kapaciteteve, pasi deri sot nuk kemi pasur histori dhe eksperiencë, por nisur nga eksperiencia e të tjerëve, bashkëpunimet me Bankën Botërore, USAID-in në këtë drejtim ka bërë që të fillojë puna përgatitore jo vetëm për kushtet, si do të licencohet dhe si do të veprojmë, por edhe për kushtet e monitorimit, i cili është tepër i rëndësishëm, në mënyrë që të rritet transparenca sa më shumë në treg.

Sfidë tjetër është rritja dhe zhvillimi i sektorit të gazit natyror. Janë bërë hapat e parë, janë hartuar rregulloret e para në lidhje me performancën, ndërkohë që për gazin natyror, ne normalisht kemi hartuar dhe miratuar tarifat e para, me shumë vështirësi, me shumë punë. Tjetër sfidë është ajo e agregimit të energjive të rinovueshme në prodhimin total të energjive (...). Kemi përgatitur dhe po vazhdojmë të përgatisim akte, kemi zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në lidhje me aplikimet, kontrollet apo përcaktimet e çmimeve, por duhet të punojmë akoma më tepër, në bashkëpunim me sekretariatën, në mënyrë që këto të integrohen me kosto më të vogël.

Çfarë ndodh? Sfidë është përpara rregullatorit, sepse (...) dhe të shpërndarjes, të cilët nga 2012 e këndej kanë pësuar një përkeqësim të theksuar të situatave të tyre financiare, si pasojë e mungesës së likuditeteve. Kjo do t'i jepte rëndësi analizës sa më të thjeshtë, në mënyrë që rregullatori të vazhdojë t'i rregullojë këto kompani. Por si do t'i rregullojë? Do t'i rregullojë duke i bërë që këto të jenë rentabël në treg, duke u siguruar vazhdimësinë e aktivitetit, por ndërkohë duke parë edhe interesat e konsumatorëve, dhe normalisht duke transpozuar të gjitha aktet ligjore apo aktet e paketës së tretë rregullatore.

Kjo është një sfidë. Normalisht kërkon ngritje të kapaciteteve të ERE-s, megjithëse, megjithëse enti rregullator i ka dhënë vazhdimisht prioritet të gjithë specialistëve për t'u trajnuar, për të mësuar në mënyrë autodidakte, për të punuar në terrene, në mënyrë që të ngrihet kërkesa. Mendoj se sot enti rregullator është i vlerësuar edhe në aspektin ndërkombëtar. Jemi lavdëruar ose jemi përgëzuar për arritjet dhe bërjen e pjesës më të madhe të akteve, po edhe për punën serioze në përgatitjen e tyre.

Sfida është monitorimi dhe përgjigja, sidomos hapja e tregut, integrimi dhe agregimi i burimeve primare të energjisë.

Patjetër që rritja e performancës është gjëja kryesore, është punë e përditshme, duke mbajtur një kosto, një tarifë, një çmim, që të jetë transparent me publikun dhe i përballueshëm nga konsumatorët dhe përdoruesit e energjisë elektrike.

Eduard Shalsi – Dy fjalë për bursën e energjisë.

Rajmonda Islamaj – Bursa e energjisë, kuptohet e është një detyrim që vjen jo vetëm prej vendimit të përcaktuar nga strategjia dhe ligji 43/2015. Së fundmi, edhe modeli i tregut, vendimi 519/ 2015 ka vendosur që të hapet tregu. Ligji ka përcaktuar etapat e hapjes së tregut, por krijimi i bursës përcaktohet dhe vendoset në këtë VKM, e cila parashikon që të fillojë nga 1 janari i 2019-ës. për këtë po bëhen përgatitjet.

Ç'është bursa? Bursa e energjisë është tregu më transparent që do të ndodhë në energji. Aty parashikohet të ketë marrëveshje të tregtimit me shumicë, pra të kontratave bilaterale të dy operatorëve, por ndërkohë parashikohet dhe tregtimi i energjisë në Intraday. Kjo do ta rrisë më tepër transparencën dhe do të sjellë çmime më aktuale dhe uljen e kostove të energjisë. Kuptohet, përveç kontratave financiare që janë parashikuar, sepse ne kemi një kontratë sipas modelit të tregut, që KESH-i dhe FSHU-ja, që janë furnizues me shumicë do të tregtojnë me kontrata afatgjata, pavarësisht se e tërë energjia do të tregtohet në bursë. Këto do të jenë kontrata financiare për të ruajtur marrëveshjen., sepse midis KESH-it dhe FSHU-së do të jetë një kontratë afatgjatë, që detyrohet të japë një sasi energjie për mbulimin e kërkesave të konsumatorëve, sidomos atyre familjarë, pra i qëndrueshëm, për të ruajtur një prodhim me kosto të ulët, që vjen nga gjenerimi vendas, që të kalojë te konsumatori më vulnerabël.

Ndërkohë kemi edhe parashikimin e kontratave për... ku do të jenë të gjitha burimet e rinovueshme , dhe për të cilat kanë fituar koncesionin. Deri më sot janë deri në 400 ..., që janë shtuar nga ato burime, duke treguar edhe rritjen e prodhimit nga ana e tyre. .këto do të jenë kontrata... metoda se si do të përcaktohet një çmim ... sipas rregullave të VKM-së. Më tej, çmimi i referencës që do të ketë çmimi i bursës, që do të tregtohet, në lidhje me diferenca midis këtyre të dyjave, kuptohet do të ketë kompensime në plus apo minus midis prodhuesve me përparësi dhe çmimit që tregtohet në bursë.

Kuptohet, ky është një bonus që kanë marrë nga çmimi fiks i përcaktuar nga kontratat për diferencë. |Duhet të jemi të kujdesshëm... Jo vetëm monitorimi i këtyre procedurave apo transparencës së të dhënave nga ana e bursës... Është e kuptueshme që për këto kontrata, ashtu siç e ka parashikuar ligji 7/2017 “Për energjinë e rinovueshme” do të ngrihet një operator për energjinë e rinovueshme, që të shohë të gjitha transaksionet, në mënyrë që të përcaktohet se sa do të jetë masa e kontributit nga secili... qoftë ai i FSHU-së i rregulluar apo ai që ka dalë në treg të parregulluar.

...edhe bashkimin me tregjet rajonale, sidomos për bashkimin e tregut me Kosovën, gjë për të cilën ka filluar puna prej vitesh, për të alternuar edhe burimet, me qëllim që të rrisim shkallën e sigurisë dhe uljen e kostos.

Eduard Shalsi – A do të fillojë të operojë bursa sipas parashikimit, në janar të vitit 2019?

Rajmonda Islamaj – Së pari duhet të ndahet OSHE-ja. Them se mund të krijohet bursa në janar të 2019-ës... normalisht edhe aktet janë në funksion. Do të hartohen kontratat financiare nga ana jonë.

Eduard Shalsi – Përmendët Kosovën. A jeni në dijeni për interkonjeksionin me Kosovën?

Rajmonda Islamaj – Gjatë viteve të fundit janë bërë investime të rëndësishme dhe një prej tyre është linja 400, që kemi bërë me Kosovën. Kjo ka rritur mundësinë e tranzitimit dhe transmetimit të energjisë...

Eduard Shalsi – Ku jemi sot? Jemi në dijeni të kësaj. Ku jemi sot?

Rajmonda Islamaj – Sot jemi në bisedime. Jo më larg se para një muaji u ngritën grupet e përbashkëta dhe ndamë detyrat. Të bashkosh tregjet, është e rëndësishme të ketë përfitim për të dy vendet. Normalisht, energjia jonë me hidro është e lirë, por ka pasigurinë e furnizimit, pasi varemi nga kushtet hidrologjike, ndërsa Kosova e ka me termo. Tashti gjendemi pikërisht në këtë situatë, kur do të përcaktojmë tarifat, metodologjinë, llojet e licencës, në mënyrë që ta facilitojmë këtë proces. Mendoj se do të mbyllet, sepse ne duhet ta finalizojmë këtë proces në interes të të dyja palëve.

Me ndihmën e IFC-së dhe ekspertëve të tjerë janë kryer studime në lidhje me rregullimin e sistemit, sidomos të atij sekondar, dhe pak a shumë, në bazë të llogaritjeve kemi rënë dakord të dyja palët. Mendoj se kjo faciliton, sepse ka edhe ndërmarrje të tjera, iniciativa të tjera për rajonin, të gjitha në mënyrë që të bashkojmë tregun me Italinë, Malin e Zi... Maqedonia dhe Shqipëria.

Eduard Shalsi – Ka pyetje ndonjë koleg tjetër ? Nuk ka.

Mirë atëherë, falënderojmë të dy kandidatët. Ne do t'ia paraqesim kandidaturat seancës parlamentare, nuk do të votojmë në komision. Thjesht do t'ia paraqesim seancës parlamentare kandidaturat.

Faleminderit!

Shihemi nesër!

MBYLLET MBLEDHJA